



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.262/2025**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj Kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike dhe private, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë; 01.02.2025, merr këtë:

**V E N D I M**

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.262/2025 e datës 30.01.2025.
- II. Subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,500.00€ (tre mijë e pesë qind) euro.
- III. Detyrohet subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Më datë 30.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, i cili pretendon se me datë 30 Janar 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj, kanë identifikuar banerët/posterët e vendosura në hapësirat/ objektet/muret/rrugët publike në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor në fuqi, të kandidatës për deputete nga radhët e PDK-së, Sala Jashari në qendrën e qytetit të Skenderajit, konkretisht në sheshin "Adem Jasharit", në sheshin e Skenderajit, të vendosur në hapësirat/muret e banesave kolektive për të cilat nevojitet aprovimi i gjithë banorëve duke qenë se të njëjtat hapësira janë pronësi e përbashkët e tyre dhe nuk dihen pjesët alikuote të gjithësecilit nga banorët, edhe po që se kandidatja në fjalë ka ndonjë leje nga organet shtetërore lokale, sikurse komuna apo të tjerat organe, këto leje i konsiderojmë abosolutisht të pavlefshme (Nule), rrjedhimisht komuna nuk ka tagër të lëshojë leje të tilla pasi që nuk është pronare e këtyre hapësirave dhe një leje të tillë eventuale e quajmë të pa efekt në bazë të ligjit (ex lege) dhe ekzistimi i saj është jo relevant për qështjen. Poashtu në ankesë theksohet se nga prova e

bashkangjitur, vërejmë se posteri del jashtë nga pjesa alikuote e banorëve (ballkonët) dhe e njëjta shtrihet edhe në muret e ndërtesës, me cka konsiderojmë se i njëjti posterë është vendosur jashtëligjshëm nga kandidatja në fjalë dhe PDK. Me këtë veprim kandidatja dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nënparagrafit 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 31.01.2025, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se ankuesi, në ankesën e tij ka theksuar se me veprimet e kandidatës për deputete znj. Sala Jashari si dhe subjektit politik PDK, është cenuar rëndë dispozita e nenit 34. paragrafi 1, nënparagrafi 12, për shkak se i njëjti ka vendosur banerin/posterin në hapësirën publike, duke qenë se të njëjtat hapësira janë pronësi e përbashkët e tyre dhe nuk dihen pjesët alikuote të gjithësecilit nga banorët. PDK në lidhje me këto pretendime, njofton PZAP-in, se kandidatja për deputete nga radhët e PDK-së, znj. Sala Jashari ka lidhur kontratë për lejimin e ngjitjes së posterit me z. Naser Tahiri - pronar i hapësirës në të cilën është vendosur baneri/posteri i pretenduar në këtë ankesë, në rr. "Adem Jashari", në Komunën Skenderaj. Gjithashtu, pretendimi i ankuesit se hapësira në të cilën është vendosur baneri/posteri janë pronësi e përbashkët e ndërtesës është i paqëndrueshëm për faktin se siç mund të vërej paneli i nderuar nga fotografitë e bashkëngjitura në këtë ankesë, posteri është vendosur në terasën e pronarit të banesës, e të cilin e shfrytëzon për tharjen e rrobave dhe e cila është pjesë përbërëse e banesës së tij dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet pronë e përbashkët e njërive banesore të kësaj ndërtese. Përgjigjes në ankesë i është bashkangjitur si provë: Kontrata për lejimin e ngjitjes së posterit në mes të znj. Sala Jashari dhe z. Naser Tahiri si pronarë i hapësirës në të cilën është vendosur baneri/posteri;

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoi për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik PDK, gjegjësisht kandidatës për deputete nga radhët e PDK-së, Sala Jashari nga ky subjekt politik, se ka vendosur banerë/posterëve në hapësirat/ muret e banesave kolektive në hapësirë publike, në rr. "Adem Jashari", në Komunën Skenderaj, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli i vlerësoi edhe pretendimet e subjektit politik PDK, në përgjigje në ankesë ku e ka kundërshtuar ankesën e parashtruesit duke theksuar se kandidatja për deputete nga radhët e PDK-së, znj. Sala Jashari ka lidhur kontratë për lejimin e ngjithjes së posterit me z. Naser Tahiri - pronar i hapësirës në të cilën është vendosur baneri/posteri i pretenduar në këtë ankesë, në rr. "Adem Jashari", në Komunën Skenderaj. Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara, për faktin se në kontratën e bashkangjitur nga subjekti politik PDK, e lidhur në mes të Sala Jashari me z. Naser Tahiri - si pronar i hapësirës në të cilën është vendosur baneri/posteri i pretenduar në këtë ankesë, në rr. "Adem Jashari", në Komunën Skenderaj, mirepo të njëjtën nuk ka mundur ta marrë për bazë me rastin e vendosjes për këtë çështje, kjo pasi që kontrata e nënshkruar nga ana e kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik PDK, dhe pronarit të hapësirës Naser Tahiri, e njëjta kontratë nuk mund të prodhojë efekt juridik, ngase përveç nënshkrimit nuk përmban vulë të protokollimit, do të thotë se nuk është lidhur para organeve kompetente. Mirëpo përkundër kësaj me asnjë provë nuk është vërtetuar se kemi të bëjmë me subjekt që ka të drejtën për të dhënë në shfrytëzim hapësirat e përbashkëta për nevoja reklamuese.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore dhe në këto zgjedhje, kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj vendosja e posterëve - njoftimeve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në vende të cilat kërkohet leje me shkrim nga organi publik apo personi që organi publik ia ka dhënë në shfrytëzim atë hapësirë, e rrjedhimisht nga kjo edhe një veprim i tillë përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjta shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të nenit 34.1 paragrafi 1.2 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përbën përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla ankimore janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga

veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.262/2025, datë 01.02.2025

**Kryesues i Panelit**  
**Arsim Hamzaj**



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së.*